



**KONTRATË MIDIS PUNËDHËNËSIT DHE SHOQËRISË ADMINISTRUESE PËR
ANËTARËSIMIN E PUNËMARRËSVE TË TIJ NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT
ME PJESËMARRJE TË HAPUR ALBSIG**

Mbështetur në nenin 62 të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe rregullores nr. 2, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimi të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”, sot më datë ____/____/____, në _____ nënshkruhet kjo kontratë:

TË DHËNAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE:

ALBSIG INVEST SH.A - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, me NUIS: L92208025J, me seli në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Downtown One, Kati 16, Tiranë, Shqipëri, e themeluar më datë 03/10/2019, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 08.10.2019, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me Licencë nr. 5, datë 22/11/2019, përfaqësuar nga Z. Elton KORBI, **Administrator i Përgjithshëm** (këtu e më poshtë “Shoqëria Administruese”).

dhe;

TË DHËNAT E E PUNËDHËNËSIT:

Shoqëria Punëdhënëse: _____, person juridik, i regjistruar me NUIS _____, me seli në adresën _____, me përfaqësues ligjor Z./Znj. _____, Administrator, (që këtu më poshtë do të quhet “Punëdhënësi”), i cili kërkon të anëtarësojë Punëmarrësit e tij në Fondin e Pensionit Privat “Albsig”.

SHOQËRIA PUNËDHËNËSE:

ALBSIG INVEST SH.A:

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm:

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë)

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë)





NENI 1 - OBJEKTI DHE BAZA LIGJORE

1. Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis Punëdhënësit dhe Shoqërisë Administruese, me qëllim anëtarësimin e punëmarrësve të tij në Fondin e Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur Albsig ("Fondi").
2. Kjo kontratë mbështetet në nenin 62, ligji nr.76/2023 "Për Fondet e Pensionit Privat", akteve nënligjore në mbështetje të tij, si dhe Prospektin e Fondit, i cili i bashkangjitet kësaj kontrate, dhe në aktet e tjera të brendshme të Shoqërisë Administruese.

NENI 2 – ANËTARËSIMI

1. Punëdhënësi duhet të informojë çdo punëmarrës të tij lidhur me anëtarësimin në fondin e pensionit privat të përzgjedhur nga Punëdhënësi. Punëmarrësi bëhet anëtar në fond me nënshkrimin e Deklaratës së Pjesëmarrjes së Punëmarrësit në Fondin e Pensionit me Pjesëmarrje të Hapur të Përzgjedhur nga Punëdhënësi.

NENI 3 - PAGESA E KONTRIBUTEVE

1. Punëdhënësi merr përsipër të paguajë kontribute në Fond në emër dhe në favor të punëmarrësve me të cilët ka lidhur kontratë pune.
2. Shuma e kontributit të punëmarrësit dhe e Punëdhënësit në emër të punëmarrësit përcaktohet nga çdo punëmarrës dhe Punëdhënësi, por jo më pak se 1,000 (njëmijë) lekë në muaj.
3. Punëdhënësi kryen pagesën mujore të kontributeve në emër dhe në favor të punëmarrësve, përfshirë edhe kontributet personale të mbajtura nga paga bruto e punëmarrësve në llogarinë e Fondit IBAN AL76 2061 1004 0000 1003 2114 7100 pranë Bankës së Tiranës sh.a., e cila do të kryejë funksionin e Depozitarit të Fondit sipas Ligjit, jo më vonë se dita e dhjetë e muajit pasardhës.
4. Pavarësisht shumës dhe periodicitetit të kontributeve të vendosur në Deklaratën e Pjesëmarrjes së Punëmarrësit në Fondin e Pensionit me Pjesëmarrje të Hapur të Përzgjedhur nga Punëdhënësi, shuma e kontributeve për t'u konvertuar në kuota do konsiderohet shuma aktuale në datën e mbërritjes në llogarinë e Fondit.
5. Në rast se Punëdhënësi apo Punëmarrësi do të ndryshojnë shumën e kontributit, Punëdhënësi duhet të njoftojë me shkrim Shoqërinë Administruese dhe kjo do të reflektohet në mënyrë automatike.

NENI 4 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

1. Të kryejë pagesat e kontributeve të Punëdhënësit dhe të Punëmarrësit duke i zbritur këto të fundit nga paga bruto e punëmarrësit;
2. Punëdhënësi, përpara kryerjes së pagesës mujore, dërgon pranë Shoqërisë Administruese sipas një formati të përcaktuar nga kjo e fundit skedulin e kontributeve duke specifikuar kontributin e paguar nga Punëdhënësi dhe kontributin e mbajtur nga paga bruto e Punëmarrësit.
3. Punëdhënësi do të informojë Shoqërinë Administruese:
 - 3.1. në lidhje me anëtarët e rinj për të cilët do të paguajë kontribute;
 - 3.2. në lidhje me anëtarët që ndërpresin marrëdhënien e punës;
 - 3.3. në rastin e humbjes së jetës së anëtarit.
4. Punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësve për mospagimin e kontributeve të parashikuara në këtë kontratë.
5. Punëdhënësi duhet të veprojë në interesin më të mirë të pjesëmarrësve në Fond dhe të jetë në përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative.

NENI 5 - POLITIKA E INVESTIMIT

1. Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata.
2. Portofoli i Fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë (letra me vlerë me maturim më të lartë se një vit) të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
3. Fondi është i ekspozuar kryesisht ndaj rrezikut të normave të

interesit, i cili përcaktohet si ndryshimi i normave të interesit të obligacioneve afatgjata në të cilat investon Fondi. Ndryshimi i normave të interesit ndikon mbi të ardhurat e Fondit dhe vlerën neto të aseteve të anëtarit. Rreziku i kredisë që mbart Fondi është lidhur ngushtë me aftësinë paguese të Shtetit Shqiptar, në obligacionet e të cilit investon Fondi, dhe përfaqëson rrezikun më të ulët të kredisë në krahasim me investimet e tjera në tregun e kapitalit

4. Karakteristikat e politikës së investimit paraqiten në Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
5. Anëtar, pasi bie dakord me këtë kontratë dhe Prospektin e Fondit, merr përsipër rrezikun e mundshëm të investimit në Fond.

NENI 6 - BANKA DEPOZITARE

1. Shoqëria Administruese ka lidhur kontratë me Bankën e Tiranës sh.a, me seli në adresën Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë, Shqipëri, e regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me Vendimin nr. 12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, NUIS: J61924008V, e cila sipas ligjit do të jetë Depozitari për asetet e Fondit.
2. Depozitari, në bazë të Vendimit Nr. 75, datë 07.10.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licencuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e Fondeve të Pensionit me Vendimin Nr.139, datë 21.12.2015.
3. Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e aseteve të Fondit. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, Prospektit si dhe të legjislacionit në fuqi.
4. Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese, dhe çdo palë tjetër të lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e Fondit të Pensionit do të shpërndahen në përputhje me ligjin dhe kontratën.

NENI 7 - PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Anëtarit të Fondit i lind e drejta për të përfutur të gjithë shumën e akumuluar në Fond apo në formë pensioni periodik:
 - 1.1. kur mbush moshën e pensionit të përcaktuar në ligjin për sigurimet shoqërore që zbatohet për atë anëtar;
 - 1.2. 5 vjet përpara se të arrijë moshën e pensionit të përcaktuar në ligjin për sigurimet shoqërore që zbatohet për atë anëtar;
 - 1.3. kur bëhet i paafte për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Punëmarrësi nuk mund t'i përfitojë kontributet e paguara nga Punëdhënësi dhe interesat e akumulara nga ato nëse ndërpret marrëdhënien e punës përpara _____ (_____) viteve nga pagesa e parë e plotë e kontributeve nga Punëdhënësi.
3. Nëse Punëmarrësi ndërpret marrëdhënien e punës brenda periudhës _____ (_____) vjeçare, Shoqëria Administruese do t'i kthejë Punëdhënësit kontributet e derdhura, bazuar në një njoftim me shkrim të Punëdhënësit. Shoqëria Administruese nuk do aplikojë penalitet mbi shumën e kthyer Punëdhënësit. Punëdhënësit i ngarkohen kosto dhe komisionet bankare.
4. Kur Punëdhënësi ndërpret marrëdhënien e punës me Punëmarrësin, në mënyrë të njëanshme, pa shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkaqe të lidhura me Punëmarrësin përpara periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, Punëmarrësi përfiton kontributet e paguara nga Punëdhënësi.
5. Kur Punëmarrësi është ai që ndërpret marrëdhënien e punës me Punëdhënësin ai mund të mbetet anëtar në Fond, apo të transferojë asetet e tij në një Fond tjetër në përputhje me dispozitat ligjore dhe me procedurat e Shoqërisë Administruese. Në këtë rast Punëdhënësi ndërpret kontributet për llogari të Punëmarrësit.
6. Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e kërkesës;





7. Anëtarit gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë "anuiteti", të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës, e licencuar nga AMF-ja. Vlera neto e aktiveve në llogarinë e Anëtarit të Fondit do të transferohet te shoqëria e sigurimit të jetës sipas opsionit të zgjedhur nga Anëtarit i Fondit. Shoqëria Administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e Anëtarit të Fondit dhe merr një konfirmim nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë "të përvitshme".
8. Pagesat periodike në formë pensioni do të kryhen jo më pak se 2 vjet mbështetur në një marrëveshje të veçantë, të lidhur midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtarit plotëson kushtet e parashikuara nga Ligji për të përfutur.
9. Pagesat e marra nga Anëtarit i Fondit të Pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, tatohet me normën në fuqi të tatimit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.
10. Me qëllim përfitimit të pagesës së të gjithë aseteve të veta në Fond, Anëtarit i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, i cili përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Shoqëria Administruese.

NENI 8 – TRAJTIMI FISKAL

1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi. Kufiri maksimal mujor, për lehtësinë tatimore, është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.
2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimin nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e Fondit të Pensionit nuk i nënshtrohen tatimit.
3. Pagesat e marra nga Anëtarit i Fondit të Pensionit në mënyrë periodike mujore tatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë.
4. Pagesat e marra nga Anëtarit i Fondit të Pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, tatohen me normën në fuqi të tatimit sipas përcaktimeve të legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.
5. Tërheqja e parakohshme tatohet me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat prsonale për vlerën e plotë të tërhequr para kohe, përfshirë kontributet.
6. Blerja e një kontrate të sigurimit të jetës në formë "të përvitshme" nga një shoqëri sigurimi jete, që sjell një produkt me të ardhura të rregullta periodike, do të trajtohet me të njëjtat lehtësi fiskale si pagesat periodike në formë pensioni të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

NENI 9 - DETYRIMI PËR INFORMIM

1. Anëtarit i Fondit njihet në çdo kohë me gjendjen e llogarisë së tij nëpërmjet një aksesit online.
2. Shoqëria Administruese, të paktën një herë në vit, duhet të njoftojë në mënyrë elektronike Anëtarin dhe Punëdhënësin për gjendjen e llogarisë së pensionit.
3. Shoqëria Administruese duhet të informojë anëtarët në Fond dhe Punëdhënësin për ndryshimet në ligj, rregulloret dhe tarifën e Fondit.

NENI 10 - TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

1. Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifën dhe komisionet si më poshtë, të cilat i ngarkohen Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit:
- 1.1. Komisioni vjetor i administrimit të Fondit do të jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Komisioni do mbahet çdo ditë dhe do të paguhet çdo muaj si shumë e vlerave ditore për atë muaj.

2. Anëtarit mund t'i ngarkohen komisione dhe tarifa si më poshtë:
 - 2.1. Komisione bankare për transfertat e fondeve sipas kushteve të bankave.
3. Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtarit në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri Administruese tjetër, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% e shumës së transferuar.
4. Çdo rritje e tarifave që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese, do t'i njoftohet anëtarëve në Fond të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se të hyjë në fuqi.
5. Shoqëria Administruese ka të drejtën e mosaplikimit të një ose disa komisioneve/tarifave për një afat të caktuar nëse këto komisione/tarifa ndikojnë në mënyrë disproporcionale në performancën e Fondit.
6. Në rastin e tërheqjes së parakohshme, Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete, të cilat parashikohen në Ligj dhe do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve, më konkretisht:
 - 6.1. 2% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
 - 6.2. 5% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë, deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
 - 6.3. 10% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë, deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
 - 6.4. 15% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.
7. Në rastin e humbjes së jetës së anëtarit, penalteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.

NENI 11 - KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar dhe do të sjellë pasoja ligjore vetëm pasi të jetë bërë pagesa e parë e kontributit.
2. Punëdhënësi mund të vendosë të ndërpresë pagesën e kontributeve kur të paktën 3 muaj përpara, ka informuar me shkrim për këtë vendim Punëmarrësin, Shoqërinë Administruese dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

NENI 12 - ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE E MOSMARRËVESHJEVE

1. Pala që do të zgjidhë kontratën duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 3 muaj përpara nga data e zgjidhjes së kontratës.
2. Çdo mosmarrëveshje mes palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptim të palëve si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
2. Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje identike; nga një për secilën palë nënshkruese.
3. Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe do të sjellë pasoja ligjore pasi të jetë bërë pagesa e parë e kontributit.

